01-309

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo **Komuna e Prishtinës** Opština Priština – Municipality of Prishtina	PRISHTINA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-383 dt. 25.02.2010, Vendimit 14-350/05-0069714/18 dt.22.08.2018, për përcaktimin e mënyrës së zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në zonat urbane, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës **05 Nr.350/03-42312/23 dt.27.02.2023** për rihapjen e procedurës së mbyllur me Vendimin e refuzimit **05 Nr.350/02-245221/21 dt.20.04.2022,** në emër të pronarëve: **Imer Mecinaj, Naser Grajçevci, Faton Mustafa, Syzana Lohaj, Blerim Grajçevci, Valon Murati dhe Rozafa Shaqiri me investitor "Cima"Sh.p.k.,** për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore afariste si fazë e parë e ndërtimit, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1" Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 31.08.2023, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. Miratohet kërkesa **05 Nr.350/03-42312/23 dt.27.02.2023** e pronarëve: **Imer Mecinaj, Naser Grajçevci, Faton Mustafa, Syzana Lohaj, Blerim Grajçevci, Valon Murati dhe Rozafa Shaqiri me investitor "Cima"Sh.p.k.,** për rihapjen e procedurës së mbyllur me Vendimin e refuzimit **05 Nr.350/02-245221/21 dt.20.04.2022,** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm/Faza e I-rë, me etazhitet 2B+P+7, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan.

II. Shfuqizohet akti administrativ "Vendim i refuzimit", **05 Nr.350/02-245221/21 dt.20.04.2022,** lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesve **Imer Mecinaj, Naser Grajçevci, Faton Mustafa, Syzana Lohaj, Blerim Grajçevci me investitor "Cima"Sh.p.k.,,** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore&afariste, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12, 744-23 ZK.Matiçan.

III. I ri-caktohen kushtet ndërtimore aplikuesve: **Imer Mecinaj, Naser Grajçevci, Faton Mustafa, Syzana Lohaj, Blerim Grajçevci, Valon Murati dhe Rozafa Shaqiri me investitor "Cima"Sh.p.k.,** sipas kërkesës **05 Nr.350/03-42312/23 dt.27.02.2023 për rihapjen e procedurës së mbyllur me Vendimin e refuzimit 05 Nr.350/02-245221/21 dt.20.04.2022,** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm/Faza e I-rë, me etazhitet 2B+P+7, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan

II. Lokacioni i parcelave kadastrale të lartcekura, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të: Planit Rregullues "Mati 1", miratuar me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati 1" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-642 dt. 01.04.2010 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues "Mati 1" të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 031-1678 dt. 20.07.2011, ku sipas këtij plani kjo zonë është e përfshirë në kuadër të ngastrës ndërtimore **"A", me tipin e shfrytëzimit C(bërthama e zonës), dhe me Planin Zhvillimor Urban** , të miratuar

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 , e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

me Vendimin 01.nr.035-181427 të dt. 24.09.2013, në bazë të të cilit kjo zonë është e paraparë për "Ndërtim të lartë".

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelave kadastrale të trajtuara, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqet, pronarët dhe klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:
  - nr. 744-15, me S=706m², me pronar:Faton Mustafa....."Arë e klasit 4";
  - nr. 744-20, me S=500m², me pronar:Imer Mecinaj....."Arë e klasit 4";
  - nr. 744-19, me S=500m², me pronar:Naser Grajçevci..... "Arë e klasit 4";
  - nr. 744-11, me S=514m², me pronar:Syzana Lohaj..... "Arë e klasit 4";
  - nr. 744-12, me S=490m², me pronar:Blerim Grajçevci..... "Arë e klasit 4";
  - nr. 744-23, me S=137m², me pronar:Valon Murati, Rozafa Shqairi..... "Arë e klasit 4";
  - **Sipërfaqja totale S=2,847.00 m²;**
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjeve të planit dhe certifikatave të njësive kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura, bazuar edhe në incizimin gjeodezik, nuk ka ndërtesa ekzistuese;
- Janë toka urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi në drejtimin veri-jug, me disnivel ~0.20m';
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është nga rruga ekzistuese "Vojislav Dançetoviq" e cila njëkohësisht është edhe e planifikuar me Planin Rregullues "Mati 1";
- Parcelat kadastrale për të cilat kërkohet caktimi i kushteve ndërtimore, shtrihen në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1", dhe pjesërisht shtrihen në rrugën e planifikuara të Planit Rregullues "Mati 1";
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelave kadastrale, përfshihen ndërtesa shumëbanesore afariste;

IV. Kushtet ndërtimore "zgjidhja urbane" e analizuar, studiuar dhe trajtuar me këto kushte ndërtimore, është konceptuar në katër grupacione/faza të zhvillimit: "Grupi I" dhe "Grupi II", me trajtim të parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan, dhe "Grupi III" dhe "IV", me analizë konceptuale të pjesës së parcelës kadastrale nr. 744-22, 744-21, 744-13 ZK Matiçan dhe parcelave kadastrale nr. 745-2 dhe 745-1, ZK.Matiçan, si në vijim:

a) "Grupi i I-rë" dhe "Grupi i II-të", Përfshinë zhvillimin e parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan dhe ka të planifikuara dy ndërtesa shumëbanesore afariste Ndërtesën I dhe Ndërtesën II. Sipërfaqja totale ndrëtimore e lejuar për zhvillimin e parcelave të lartcekura përfshirë këtu edhe shpronësimin është ***6,897m²***;Me anë të këtij Vendimi do të caktohen kushtet ndërtimore për lejimin e ndërtimit të "Ndërtesës I" me etazhitet 2B+P+7, me sipërfaqe ndërtimore prej ***S=3,792.22m²***, ndërsa realizimi i sipërfaqes së mbetur ndërtimore gjegjësisht ndërtesës 2 është i lidhur me finalizimin e zgjidhjes urbane në bahkëpunim me grupacionin e tretë të zhvillimit.

b) "Grupi i III-të", Përfshinë zhvillimin e parcelave kadastrale nr.744-22, 744-21 dhe 744-13, ZK.Matiçan. Në kuadër të këtij grupacioni është propozuar /planifikuar ndërtimi i një ndërtesës shumëbanesore afafriste. Realizimi i të drejtës ndërtimore të këtij grupacioni është ngushtë i ndërlidhur me zhvillimin e grupacionit të II të ndërtimit.

c) "Grupi i IV-të", përfshinë zhvillimin e parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale nr.745-2 dhe 745-1, ZK.Matiçan. Ky grupacion zhvillohet në bashkëpunim me Grupacionet I, II dhe III. Kushtet ndërtimore për "Grupi i IV-të" për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit do të përcaktohen me kërkesë të pronarëve - grupeve të interesit dhe investitorit;

d) Për zhvillimin e papenguar duke i respketuar kriteret e planit

për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin-ndërtimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste, në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë si në vijim:

- **Organizimi i situacionit** me qasje në kompleks, pozicionimi, gabaritet dhe lartësitë e ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesave ndërmjet vete dhe nga kufiri i parcelave, rrugët e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas kritereve të Planit Rregullues "Mati 1" të përshkruara në këtë vendim dhe

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 - e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

prezantimit grafik të përshkruar në planin e lokacionit – "zgjidhja urbane", bashkangjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- **Parcelat brenda bllokut urban** me sipërfaqet e trajtuara, për realizimin e ndërtesës shumë banesore dhe afariste, konkretisht parcelat kadastrale të përfshira dhe të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:
  - nr. 744-15, me S=377m²,
  - nr. 744-20, me S=260m²,
  - nr. 744-19, me S=381m²,
  - nr. 744-11, me S=271m²;
  - nr. 744-12, me S=490m²;
  - nr. 744-23, me S=137m²;

  Sipërfaqe totale brenda vijës rregulluese, e parcelave kadastrale është **S=1,916.00m²;**

- **Parcelat jashta vijës rregulluese** dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, jashtë vijës rregulluese të planifikuara për rrugë, janë si në vijim:
  - nr. 744-15, me S=320m²,
  - nr. 744-20, me S=63m²,

  Sipërfaqe totale e trajtuar jashta vijës rregulluese, e parcelave kadastrale është **S=383 m²;**

- **Pjesët e parcelave kadastrale të patrajtuara me këto kushte ndërtimore**, jashtë vijës rregulluese të planifikuara në bllokun tjetër dhe në rrugë, janë si në vijim:
  - nr. 744-15, me S=9m²,
  - nr. 744-20, me S=177m²,
  - nr. 744-19, me S=119m²;
  - nr. 744-11, me S=243m²;

  Sipërfaqe totale e parcelave e patrajtuar me këto kushte ndërtimore është **S=548 m²;**

Sipërfaqja e parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19 dhe 744-11, ZK.Matiçan, e planifikuar në rrugë sipas Planit Rregullues "Mati 1" Prishtinë, është S=893m².Me aplikimin e Vendimit 14 Nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës Prishtinës, Nr.01 Nr.400-600 dt. 26.05.2008, për kompensimin e pronës private për interes publik me koeficient të ndërtimit, sipas të cilit deri në 20% të parcelës ndërtimore, mund të kompensohet, dhe sipas kalkulimit sipërfaqja prej 383m² e shprehur në përqindje do të jetë 20%, sipërfaqe e përfshirë në hapësira me interes publik me koeficient të ndërtimit, sipërfaqja jashtë parcelës ndërtimore-vijës rregulluese, do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore si në vijim:

S=383m²*3.0=1,149m²

- Me këto kushte ndërtimore, në kuadër të parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan, planifikohet të realizohen/ndërtohet ndërtesa me etazhitet 2B+P+7, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

  Sipërfaqja totale ndërtimore e propozuar për ndërtim do të jetë **Stotal=4,997.58m²** nga kjo **Stotal=3,792.22m² mbi tokë dhe 1,205.36m² nën tokë;**
- **Destinimi** i shfrytëzimit të ndërtesave, sipas planit rregullues, të jetë për "banim" , si dhe hapësira afariste, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj.(sipas projekt propozimit të prezantuar);
- **Etazhiteti** maksimal sipas Planit Rregullues është IV-VIII ndërsa sipas PZHU-së është VII-IX, i propozuar dhe i miratuar me këto Kushte Ndërtimore është 2B+P+7;
- **ISHP**-Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese, sipas Planit Zhvillimor Urban është 30-40%.

  Sipërfaqja totale brenda vijës rregulluese e trajtuar me këto kushte ndërtimore është

  S=1,916.00m²*max.40%=766.40m²/sipas planit rregullues/;

  S= 453.5 m² /sipas projekt propozimit/për fazën I

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë

- **ISPN** -Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Zhvillimor Urban, është 1.8-3.0, ndërsa sipas P.RR.Urban "Mati 1" është 3.0, dhe meqë koeficienti i planit nuk e tejkalon koeficientin e përcaktuar të PZHU-së, si i vlefshëm përvetësohet koeficienti i Planit Rregullues "Mati 1". Koeficienti ndërtimor i parcelave kadastrale të bashkuara brenda vijës rregulluese–parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: ***100%*** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi ***51%*** mbi tokë-suteren, dhe ***0%*** për etazhet e nëntokës-bodrume, dhe kjo sipërfaqe, për pjesën e parcelave brenda vijave rregulluese do të jetë si në vijim:
  - Sipërfaqja totale e parcelave kadastrale brenda vijës rregulluese të Planit Rregullues "Mati 1" është **S=1,916.00m²**, që kalkulohet si në vijim:

    S=1,916.00m²x3.0=5,748.00m²;

    Me anë të këtij Vendmimi caktohen kushtet për ndërtimin e Nërtesës I, e sipërfaqes prej S=3,792.22m²
  - Sipërfaqja e parcelave kadastrale e planifikuar për rrugë publike sipas P.RR"Mati 1", e planifikuar të kompensohet sipas përshkrimit në pikën në pikën "V" të këtij vendimi është **383m², që kalkulohet si në vijim:**

    S=383m²*3.0=1,149m²
  - Nga kjo sipërfaqja ndërtimore totale do të kalkulohet si në vijim:

    S=5,748.00+1,149.00m²=6,897m²;

    Me anë të katyre kushteve ndërtimore është planifikuar për ndërtim sipërfaqja prej 3,792.22m², Ndërsa sipërfaqja e mbetur prej 3,104.78m², planifikohet të trajtohet me zgjidhjen urbane të pjesës tjetër të bllokut gjegjësisht pjesës së mbetur te bllokut.
- **ISHPN**-Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit është max. **60%**, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

  S=1,916.00m²*max.60%=1,149.60m²

  S= 696.40 m² /sipas projekt propozimit/për fazën I
- **ISHGJ**-Koeficienti i shfrytëzimit maksimal i parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është min.**40%**, dhe kjo sipërfaqe për këtë kompleks, duhet të jetë:

  S=1,916.00m²*max.40%=766.40m²/

  Sipas prjektpropozimit S=766.40m²
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, tipi i mbulimit d2, mundëson ndërtimin e ndërtesave me një gjatësi prej maksimum 50 m. dhe sipërfaqe te lire prej 0,4 x h-lartësia e ndërtesës ose se paku 3m. Gjashtë etazhet e para të ndërtesës në frontin rrugor, me thellësi të ndërtimit prej maksimum 16 m, mund të ndërtohen me distancë anësore prej së paku 3 metra, nga kufiri ose ndërtesa tjetër.
  Etazhet mbi etazhin e tetë duhet të ndërtohen me gjatësi maksimale prej 20 metra dhe sipërfaqe të lirë prej 0,4 x lartësia e objektit.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efiçiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdheses nga niveli i terrenit, nga rruga–niveli i terrenit maks.1.2m për banim dhe 0.3 për afarizëm;
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues, të prezantuar në Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane" të kompleksit;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve (shfrytëzuesve) të ndërtesave kolektive të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, standardi i parkimit respektivisht i garazhimit sipas Planit Rregullues "Mati 1" dhe Rregullores MMPH nr.03/2016, është 1 VP/ një banimi. Për pjesën e afarizmit min. 1 vendparkim për 30m² afarizëm sipërfaqe të shfrytëzueshme. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritit të ndërtesës. Kompleksi të organizohet edhe me vend-parkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotuaret, terrenet sportive, këndet e lodrave për fëmijë, etj.;

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 - e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efiçiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. Kompensimi / shpronësimi me koeficient ndërtimi i pjesëve të parcelave nr.744-15, 744-20, 744-19 dhe 744-11, ZK.Matiçan, me S=383m², të përfshira në hapësirë publike të planifikuara – rrugë, për realizimin e ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore dhe afariste, të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në pikën "IV", parcelat ndërtimore kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan, janë me sipërfaqe prej S=1,916.00m², ndërsa sipërfaqja prej 893m² është e përfshirë në infrastrukturën rrugore sipas P.RR.Bazuar në Vendimit 14 Nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës Prishtinës, Nr.01 Nr.400-600 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, me anë të këtij Vendimi caktohet shpronësimi i parcelave kadastrale 744-15 me S=320m² dhe 744-20 me sipërfaqe prej 63m², sipërfaqe përcaktuar në përqindje (20%) është 383m² dhe do të kompensohet si në vijim:

S= 383m²*3.0=1,149m².

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin/shpronësimin me koeficient ndërtimi të pjesëve të parcelave kadastrale, bazuar në vendimet e lartcekura. Kjo procedurë e kompensimit/shpronësimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Drejtoria e Pronës, para arritjes së marrëveshjes sipas këtij paragrafi, të konsultojë rregullativën ligjore në fuqi dhe të verifikojë sipërfaqet e sakta të parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga bashkëpronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

Procedura e kompensimit të parcelave kadastrale të lartcekura do të bëhet në fazën e dytë të zhvillimit.

VI. Ndarja/parcelimi i parcelave kadastrale nr.744-15, 744-20, 744-19 dhe 744-11, ZK.Matiçan, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, si dhe bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane", vijës rregulluese të bllokut urban , dispozitës urbanistike punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes dhe bashkimit, të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Bashkimi i pjesëve & parcelave kadastrale, nr.744-15, 744-20, 744-19, 744-11, 744-12 dhe 744-23, ZK.Matiçan, në pronësi private, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban , bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", si dhe Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e re-Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Mati 1", në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim të punuar nga gjeometri i liçencuar.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të proceduarave të paragrafit V. & VI. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operatin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga P.RR "Mati 1" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar .

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë vendimin e kushteve ndërtimore, gjegjësisht anulimin e tyre.

IX. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR ''Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të Ndërtesat (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

X. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, *"Rregulloren mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi ", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016,* bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshitë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;

Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 - e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin për masat mbrojtëse kundër zjarrit;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

XI. Dokumentacioni ndërtimor për **Masat e mbrojtëse nga zjarri** të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
